



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1283/1 Prot.

Tiranë, më 07.05 2025

V E N D I M

Nr. 57 dt. 07.05 2025

“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN PËR SISTEMIN E
MONITORIMIT ME VIDEO MBIKQYRJE NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË
TIRANËS”

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 4, pika a, nenin 33 paragrafi 3, nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në nenin 7 paragrafi 2 pika b, nenin 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, Relacionin nr. 1044/1 Prot. datë 23.04.2025 të Grupit të Punës, Vendimin e Rektoratit nr.53, datë 06.05.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 07.05.2025

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren “Për sistemin e monitorimit me video mbikqyrje në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, (bashkëlidhur vendimit).
2. Ky vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim të gjitha njësive përbërëse të UST-së dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Sherbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**

**RREGULLORE
PËR SISTEMIN E MONITORIMIT ME VIDEO-MBIKËQYRJE NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS**

Miraturar me Vendimin e Senatit Nr. 57, datë 07.05.2025

Rr. Muhamet Gjollësja, Tiranë, Tel: 35542226652, www.ust.edu.al, contact@ust.edu.al

PËRMBLEDHJA:

Neni 1	Qëllimi
Neni 2	Baza Ligjore
Neni 3	Fusha e zbatimit
Neni 4	Qëllimet e përpunimit të të dhënave
Neni 5	Masat teknike
Neni 6	Masat Organizative
Neni 7	Inspektimi nga ana e monitoruesit
Neni 8	Aksesimi dhe ruajtja e pamjeve
Neni 9	Njoftimi për monitorimin me video-mbikëqyrje
Neni 10	Detyrat dhe përgjegjësitë e monitoruesit
Neni 11	Dokumentacioni që mban monitoruesi
Neni 12	Anekset
Neni 13	Dispozita përfundimtare
Neni 14	Hyrja në fuqi

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 QËLLIMI

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e përdorimit të sistemit të monitorimit me video-mbikëqyrje në ambjentet e universitetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me synim garantimin e sigurisë së stafit, studentëve dhe pronës. Sistemi nuk duhet të ndërhyjë në jetën private të individëve.

Neni 2 BAZA LIGJORE

Baza ligjore e kësaj rregulloreje shtrihet në aktet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare. Në aktet ligjore kombëtare bëjnë pjesë:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Ligji Nr.19/2016 “Për masat shitesë të sigurisë publike”, Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Udhëzimi i MPB Nr. 134, datë 10.03.2017 “Për përcaktimin e nivelit të masave shitesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre”, Udhëzimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr. 64 datë 28.03.2017 “Për përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të Ligjit Nr.19/2016.

Në aktet ndërkombëtare bëjnë pjesë:

- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)
- Konventa nr. 108 e Këshillit të Evropës (1981) – “Për Mbrojtjen e Personave në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale” Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (1948)

Neni 3 FUSHA E ZBATIMIT

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha ambjentet e brendshme dhe të jashtme të Universitetit të Sporteve të Tiranës ku është vendosur sistemi i monitorimit me video-mbikëqyrje për qëllime sigurie, përjashtuar zonat që çënojnë privatësinë personale (tualet, dhoma zhveshjeje, zyra personale etj).

1. Nëpërmjet sistemit të monitorimit me video-mbikëqyrje monitorohen godinat e universitetit, shesh-pushimi i automjeteve, rrugëkalimet dhe shesh-pushimet kryesore të jashtme, rrugëkalimet e brendshme, laboratorët.
2. Qasja në të dhënat personale të siguruar përmes sistemit të monitorimit me video-mbikëqyrje kryhet vetëm nga personi i autorizuar. Personi i autorizuar është trajnuar

për përdorimin e pajisjeve teknologjike dhe ka nënshkruar deklaratën e konfidencialitetit, e që këtu e më poshtë do të quhet “Monitoruesi”.

Neni 4

QËLLIMET E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE

Të dhënat e përfituara nga sistemi i monitorimit me video-mbikqyrje përdoren vetëm për:

1. Garantimin e sigurisë së stafit, studentëve dhe palëve të tjera që hyjnë dhe dalin nga ambientet e universitetit;
2. Mbrojtjen e pronës së universitetit.

KREU II

MASAT TEKNIKE DHE ORGANIZATIVE

Neni 5

MASAT TEKNIKE

1. UST merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme në mënyrë që të mbrohen sistemet e regjistrimit, mënyrat e transferimit dhe mjetet transmetuese në të cilin gjenden regjistrimet duke i mbrojtur nga aksesit i paautorizuar apo aksidental, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar.
2. Të dhënat personale do të mbahen të sigurta dhe nuk do të keqpërdoren në asnjë mënyrë. UST ka marrë të gjitha masat fizike për ruajtjen e këtyre të dhënave të cilat janë të njëjta me ruajtjen e të dhënave të tjera. UST organizon punën në mënyrë të tillë që risku të minimizohet duke siguruar që personeli të mund t'i shohë të dhënat vetëm kur kjo është e nevojshme.
3. UST zbaton masat teknike të mëposhtme për fshehtësi dhe mbrojtje të përpunimit të të dhënave personale të siguruara përmes sistemit të monitorimit me video-mbikqyrje:
 - a. Për secilën pajisje Monitoruesi ka fjalëkalim unik;
 - b. Fjalëkalimi është i përbërë nga një kombinim shkronjash, numrash si dhe minimumi një karakter special;
 - c. Për arsye sigurie fjalëkalimi ndryshohet në mënyrë periodike;
 - d. Sistemi bën refuzim automatik pas përpjekjeve të pa-suksesshme për hyrje (futje të emrit të përdoruesit apo fjalëkalimit të gabuar);
 - e. Lidhje të sistemit të monitorimit me video-mbikqyrje në rrjetin elektrik për furnizim të pandërprerë me energji elektrike.

Neni 6

MASAT ORGANIZATIVE

Universiteti i Sporteve të Tiranës zbaton masat organizative të mëposhtme për fshehtësi dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale të siguruar përmes sistemit të monitorimit me video-mbikëqyrje:

- Qasje të kufizuar për të hyrë në sistemin e monitorimit me video-mbikëqyrje, në mënyrë të tillë që vetëm Monitoruesi të mund ta ketë këtë qasje;
- Respektim i udhëzimeve teknike gjatë instalimit dhe përdorimit të pajisjeve për video-mbikëqyrje.
- Pozicionimi i kamerave është i tillë që nuk lejon regjistrimin e imazheve jashtë këtyre ambienteve.

KREU III

PROCEDURAT E MONITORIMIT

Neni 7

INSPEKTIMI NGA ANA E MONITORUESIT

Për hyrjen dhe inspektimin e të dhënave personale të siguruar nëpërmjet sistemit të monitorimit me video-mbikëqyrje në Universitetin e Sporteve të Tiranës, zbatohen masat e mëposhtme:

1. Hyrja në sistemet e monitorimit me video-mbikëqyrje është me akses të kufizuar.
2. Shmanget çdo mbikëqyrje e panevojshme apo e tepruar;
3. Vendosja e kamerave bëhet vetëm në zona të nevojshme për siguri;
4. Të drejtën për të hyrë në sistemin e monitorimit me video-mbikëqyrje e ka vetëm Monitoruesi.

Neni 8

AKSESIMI DHE RUAJTJA E PAMJEVE

1. Regjistrimet ruhen në hard disqet e pajisjeve DVR/XVR.
2. Të dhënat e mbajtura në sistemet e video-mbikëqyrjes ruhen për një periudhë deri në 1 (një) muaj.
3. Pamjet nuk shpërndahen nëse nuk ka një kërkesë të shkruar të protokolluar, të aprovuar nga titullari i universitetit.
4. Pamjet nuk shpërndahen pa arsye ligjore.

Neni 9

NJOFTIMI PËR MONITORIMIN ME VIDEO-MBIKËQYRJE

Hapësirat e mbikëqyrura me kamera janë të pajisura me modelin standard të tabelës informuese. Tabelat informuese janë të vendosura në vende të dukshme dhe të qarta me të dhënat:

- Emri i kontrolluesit
- Kontaktet e kontrolluesit
- Të dhënat e komisionerit

Neni 10

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E MONITORUESIT

Detyrat dhe përgjegjësitë e Monitoruesit përkufizohen si më poshtë:

1. Administron dhe përgjigjet për mirëfunksionimin e sistemit të monitorimit me video-mbikëqyrje. Ai kryen kontrole të rregullta periodike, në ditët e hëna të para dhe të treta të çdo muaji, për të siguruar që:
 - Sistemi është në gjendje pune në tërësi;
 - Të gjitha kamerat kanë sinjal të rregullt;
 - Të gjitha kamerat janë në regjim regjistrimi;
 - Data dhe ora e sistemit të monitorimit me video-mbikëqyrje janë të sakta.
2. Raporton tek titullari i universitetit për dëme apo probleme që mund t'i jenë shkaktuar sistemit të cilat kërkojnë vëmendje të menjëhershme.
3. Nxjerr nga arkiva filmimet apo pamjet statike në bazë të një kërkesë të shkruar të protokolluar, të aprovuar nga titullari i universitetit.

KREU IV

PËRGJEGJËSITË DHE DOKUMENTACIONI

Neni 11

DOKUMENTACIONI QË MBAN MONITORUESI

1. Monitoruesi disponon të gjithë dokumentacionin që lidhet me rregulloren për sistemin e monitorimit me video-mbikëqyrje për Universitetin e Sporteve të Tiranës. Monitoruesi disponon vendime dhe urdhra të Rektoratit të UST që lidhen me veprimtarinë e monitorimit nëpërmjet sistemit të video-mbikëqyrjes me kamera.
2. Monitoruesi disponon dhe ruan kërkesat për nxjerrjen nga arkiva të filmimeve dhe/ ose pamjeve statike.

3. Monitoruesi disponon dokumentacionin bazë të organizimit, funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së ambientit të monitorimit.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12

Anekset

Kjo rregullore përmban Aneksin I, II, III, anekse që janë pjesë përbërëse e saj dhe që mund të shtohen apo ndryshohen në të ardhmen.

Neni 13

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Zbatimi i kësaj rregulloreje do të mbikëqyret nga personi i autorizuar.

Neni 14

HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga Senati Akademik i UST-së.